



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:159622

Datë: 28.05.2024

Numri i dokumentit: 05743256

P.nr.226/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me bashkëpunëtorin profesional Ismajl Kuçi në çeshtjen penale ndaj të pandehurit M.K nga fsh..., i akuzuar për veprën penale, Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.1141/21 të datës 11.08.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.02.05.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Mimoza Sylja-Hyseni, të dëmtuarit A. T.dhe të pandehurit, me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare, av. Shpëtim Vishi, në mungesë të dëmtuarit Sh. K., me dt.03.05.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me datë 27.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri M.K nga fsh. ... Komuna Kaçanik, i lindur më dt.... , nga i ati I... dhe e ëma H..., e gjinisë V... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal: ...

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 03.08.2022, rreth orës 06:00 në fshatin Kaçanik i Vjetër-Kaçanik, saktësisht tek lagjja e “Topojanëve”, i pandehuri me dashje dhe me qëllim i ka kanosur seriozisht se do ti sulmojë personat zyrtarë në Agjencionin e Pyjeve të Kosovës, Sh.K.dhe A. T. në lidhje me detyrën e tyre zyrtare, në atë mënyrë që derisa të dëmtuarit- zyrtarët e pyjeve kishin qenë duke kontrolluar pyllin kanë hasur tek i pandehuri i cili kishte qenë duke bartar drunjë me qerre me kali të cilat i ka prerë pa leje në pronë publike dhe posa ishin afruar tek i pandehuri, i njëjti i ka ofenduar me fjalë të ndryshme banale “ropt jav q...” e më pas e kishte marrë një sëpatë ku fillimisht iu kishte vërsulur të dëmtuarit Shefit Kuqi që ta sulmojë, e në atë moment ka ndërhyrë i dëmtuari Alejdin Troni dhe ka arritur të i'a marrë sëpatën nga dora, e pastaj i pandehuri përsëri ka nxjerr një thikë nga brezi duke e mbajtur në dorë dhe duke e kanosur të dëmtuarin A.T.me fjalët “ nuk ndalem duke bart drunjë, dërgomëni në burg, përsëri jam këtu, dhe ja keni me më vra, ja ka me ju vra juve” dhe i njëjti kishte tentuar të largohet nga aty, por me asistimin e policisë kishin arritur që ta ndalonin e pastaj të njëjtin ta shoqëronin për në stacionin policor në Kaçanik.

Me këto veprime i pandehuri ka kryer veprën penale, Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.1 të KPRK-së

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,48,69,70,71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Me dënim me kusht, me të cilin i vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i pandehuri në afat prej dy viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk do të kryejë veprë tjetër penale, në të kundërtën do t'i revokohet dënimi me kusht.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate shumën prej 30.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

I dëmtuari Alejdin Troni, nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike, ndërsa i dëmtuari Shefit Kuqi, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.1141/21 të datës 11.08.2022 të pandehurin M.K nga ...-Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale, Sulm ndaj personit zyrtar nga neni 402 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.11.10.2023 me te cilin rast, I pandehuri , pas prezentimit te aktakuzës nga prokurori I shtetit, nuk e ka pranuar plotësisht fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 02.05.2024, prokurorja e shtetit Mimoza Sylja-Hyseni , me rastin e prezentimit të aktakuzës, bëri rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale, Sulmi nga neni 402 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, në veprën penale, Sulmi nga neni 402 par.1 të KPRK-së, ndërsa pjesa tjetër mbetet e pandryshuar.

I dëmtuari Alejdin Troni, në fjalën e tij në shqyrtim gjyqësor nuk I bashkangjitet ndjekjes penale dhe nuk ka parashtruar kërkesë pasurore juridike, ndërsa I dëmtuari Shefit Kuqi, nuk ka qenë prezent në shqyrtimin gjyqësor.

I pandehuri në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, duke shprehur pendesë për veprimin e tij, duke I kërkuar falje të dëmtuarit dhe duke i premtuar gjykatës se veprime të tilla apo të ngjashme, nuk do të përsërisë në të ardhmen, prandaj edhe i ka kërkuar gjykatës, që me rastin e marrjes së vendimit, t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur, meqë tani edhe ashtu nuk është duke shku në mal për të marrë dru, por është duke punuar në fabrikën “Simtex”si roje sigurie.

Prokurori I shtetit, i dëmtuari Alejdin Troni dhe mbrojtësi i të pandehurit, nuk e kanë kundërshtuar pranimin e fajësise nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 322 lidhur me 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajesisë, se pranimi i fajesisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çeshtjes që permban akuza, se akti akuzues nuk permban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike andaj shqyrtimin gjyqësor e vazhdoi pa administrimin e provave tjera.

Prokurorja e shtetit në fjalën e saj përfundimtare deklaroi se, nga vetë pranimi i fajesisë nga ana e të pandehurit, i cili vullnetarisht e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv, andaj edhe i propozon gjykatës që të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'i shqiptojë sanksion penal sipas ligjit, duke patur parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajesisë, ndërsa si rrethanë rënduese, numin e viktimave, gjegjësisht faktin se në rastin konkret janë dy persona të dëmtuar. Me fjalën përfundimtare të prokurores, pajtohet edhe i dëmtuari.

Mbrojtësi i të pandehurit në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, pasi që i mbrojturi i tij, e pranoi fajësinë në mënyrë të sinqertë dhe vullnetare, duke i kërkuar falje të dëmtuarit, dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë këso veprime, i kërkon gjykatës që me rastin e matjes së dënimit, ti shqiptohet një dënim me gjobë sa më i ulët që të jetë e mundur, duke patur parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajesisë nga i mbrojturi i tij, kërkimfaljen, premtimin se nuk do të përsërisë, në të ardhmen, këso vepra penale, si dhe gjendjen e dobët ekonomike të tij. Me fjalën përfundimtare të mbrojtësit të tij, pajtohet edhe i pandehuri.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Sulmi nga neni 402 par.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në seancën e parë të shqyrtimit gjyqësor, ka premtuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, ndërsa si rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti faktin se, i njëjti ka sulmuar dy persona-roje pylli dhe faktin se, bazuar në evidencën e gjykatës, i njëjti ka patur raste të tjera penale, për të cilat është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë, dhe

kryesisht për veprën penale, Vjedhje pylli, por që në rastin konkret, pikërisht kjo veprë ndërlidhet edhe me rastin në fjalë.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin M.K, i akuzuar për veprën penale, Sulmi nga neni 402 par.1 të KPRK-së, e gjykoj me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore juridike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.226/22 datë 27.05.2024

Bashkëpunëtori profesioanl
Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,
Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.